



**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**  
**KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN**

**Drejtoria për Prokurim Publik**  
**14 Nr. 718/24**  
**Daët 10.09.2024**

Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të subjektit në procedurë: **DIAMANTI SH.P.K**, Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik e Komunës së Vushtrrisë, pas mbajtjes të seancës jo publike të shqyrtimit të kërkesës në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 6 lidhur me pikën 10 paragrafi 10.1 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, me datën 10.09.2024, merr këtë:

**VENDIM**

- 1. REFUZOHET plotësishtë e pabazar** Kërkesa për rishqyrtim e subjektit në procedurë : **DIAMANTI SH.P.K**, lidhur me Njoftimin mbi Vendimin e AK në këtë aktivitetet të prokurimit me titull: *Ndertimi i stacionit te pompimit rrjetit primar dhe rezervuarve te ujit,ne pjesen lindore te Vushtrri sipas lot I dhe lot II-ri tenderim me numër prokurimi: VU644-24-8479-5-1-1*, inicuar nga AK – Komuna e Vushtrrisë.
- 2. Lënda**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull *Ndertimi i stacionit te pompimit rrjetit primar dhe rezervuarve te ujit,ne pjesen lindore te Vushtrri sipas lot I dhe lot II-ri tenderim me numër prokurimi: VU644-24-8479-5-1-1*, është korigjuar paraprakishtë dhe plotëson të gjitha konditat andaj AK – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik e Komunës së Vushtrrisë vazhdon me procedurën e prokurimit.

**A r s y e t i m**

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik e Komunës së Vushtrrisë (në tekstin e mëtejme A.K.) në bazë të kërkesës së Njësisë Kërkuese ka inicuar aktivitetin e prokurimit me titull: *Ndertimi i stacionit te pompimit rrjetit primar dhe rezervuarve te ujit,ne pjesen lindore te Vushtrri sipas lot I dhe lot II-ri tenderim me numër prokurimi: VU644-24-8479-5-1-1*.

Më 09.09.2024, Autoriteti Kontraktues përmes platformës e-prokurimi ka pranuar Kërkesën për Rishqyrtim të parashtruar nga operatori ekonomik **DIAMANTI SH.P.K** kundër Njoftimin mbi Vendimin e AK dhe kriterëve, arsyetimin e Kërkesës për rishqyrtim, **DIAMANTI SH.P.K**, (në tekstin e mëtejme Ankuesi) pretendon se, A.K. nuk ka respektu në plotëni procedurat dhe kriteret e vendosjes.

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik e Komunës së Vushtrisë, gjatë fazës së shqyrtimit paraprak ka konstatuar se ankesa i përmban elementet e përcaktuara përmes nenit 60 paragrafi 3 të Rregullorës Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 108/A paragrafin 3.1 të LPP në procedurë paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë AK ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë kërkesë sipas nenit 108/A të LPP lidhur me nenin 63 të RRPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e saj në mënyrë meritore.

Autoriteti Kontraktues, pasi shqyrtoi një nga një pretendimet e OE ankues të parashtruara në Kërkesën për Rishqyrtim në kontekstin e përgjithshëm të kërkesave dhe kushteve të zbatueshme të dosjes së tenderit/njoftimit për kontratë, fakteve të pohuara nga OE ankues, duke pasur parasysh natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit dhe duke u mbështetur në LPP dhe RRPP, **gjete se kërkesa për rishqyrtim REFUZOHET plotësisht e pabazar.**

AK – ZPP, lidhur me deklaratimet zyrtare të OE të paraqitura në kërkesen për ri-shqyrtim e të cilat po i paraqesmi në vijim:

#### Vërejtje

Me këto kërkesa, te panevojshme, jo profesionale dhe aspak te logjikshme po ju njoftojmë se nuk mund të ketë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik, përndryshe do të ketë diskriminim të hapur dhe përcaktim të fituesit qysh në start të këtij aktiviteti të prokurimit, andaj këto kërkesa të cilat ja kenë përshtatur një OE të caktuar, ku kenë kërkuar llojin e mekanizmit të cilën e posedon vetëm një kompani në rajonin e (Kosovës), mekanizëm i cili është panevojshëm për ekzekutimin e projektit dhe njeherit me vetëdije të plot po e dëmtoni taksën e qytetareve, përkatësisht dëmtimin e buxhetit të Komunës dhe Shtetit

#### Sqarim

Vlen të theksohet se këto kërkesa te panevojshme dhe diskriminuese po keqpërdoren nga stafi juaj i brendshëm i komunës, gjegjësisht nga zyra e prokurimit në bashkëpunim me zyrën e Urbanizmit përkatësisht nga z Nexhat Merovci, ku për këtë mund të vërtetojmë me dëshmi dhe fakte të aktiviteteve të mëparshëm

**Valle:**

Si është e mundur të publikohet projekti i ndertimit të ujesjellesit në lot I dhe lot II, me të njëjtat veprimtari të punës, po ashtu në të njëjtin vlerë, ndërsa me kërkesa të jenë krejtësisht të ndryshme, ku sipas mendimit të këtyre veprime janë jo profesionale, të dyshimta dhe të palogjikshme / paradoksale.

Një veprim (anomali e tillë) nga një analizë e thjeshtë, shihet qysh në fillim dhe kuptohet lehtë (vrehet haptazi) se me këto kërkesa të kushtëzuara nga ana juaj, përfituesi i këtij aktiviteti të prokurimit vetëm se është përcaktuar me publikimin e njoftimit për kontratë.

Ky tender është i përgaditur në teresi (100%) për kompani të caktuara, ku si pasoje e saj pamundëson pjesëmarrjen e kompanive tjera në ofertimin e këtij tenderi, për arsye se kërkesat ndryshojnë për Lot 1 dhe Lot 2, gjë që nga kjo kuptohet se do të ekzekutohet e njëjta punë, e këto kërkesa janë si në vijim:

- a) Ndryshimi i kërkesave të Listës së kontratave dhe referencave për lot I dhe lot II.
- b) Ndryshimi i stafit profesional (Inxhinierëve) për lot I dhe lot II.
- c) Ndryshimi i listës së mekanizmit për lot I dhe lot II.
- d) Ndryshimi tek lista e puntave teknik për lot I dhe lot II.

Për të njëjtin aktivitet të prokurimit keni formuluar kërkesa të ndryshme tek lista e kontratave, lista e stafit profesional dhe lista e mekanizmit për Lot 1 dhe për Lot 2 e ku bëhet fjale për punë të njëjta, pra ndertim të rrjetit të ujesjellesit.

Në momentin që përshtaten kërkesat atëherë OE i cili i plotëson këto kërkesa do të ofertojë me çmim shumë më të lartë, ashtu siç ka ndodhur në shumë raste.

Ju njoftojmë se këtë tender me këto kërkesa dhe dëshmi të kërkuara në konsiderojmë tender të kurditur nga departamenti i prokurimit në bashkëpunim me Drejtorin e Urbanizmit përkatësisht z.Nexhat Merovci,

***Përgjigja e ZPP***

AK –ZPP, me këtë rastë ngrit shqetësimin lidhur me këto akuza të pretenduara e të deklaruara nga pretenduesi duke theksuar se posedon prova e argumente po citoj **“Vlen të theksohet se këto kërkesa të panevojshme dhe diskriminuese po keqpërdoren nga stafi juaj i brendshëm i komunës, gjegjësisht nga zyra e prokurimit në bashkëpunim me zyrën e Urbanizmit përkatësisht nga z Nexhat Merovci, ku për këtë mund të vërtetojmë me dëshmi dhe fakte të aktiviteteve të mëparshëm”** paraqites i Kërkesës për Rishqyrtim **DIAMANTI SH.P.K** të cilën e përfaqëson z. Azem Tahiraj me këtë rastë akuzon stafin dhe persona sipas nesh pa patur asnjë arsye apo bazë ligjore dhe tenton që me gjuhen e kërcenimit nga autoritetit kontraktues të imponoj ndryshime në DT në favorin personal.

***Nga pozita e Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit Publik Komuna Vushtrri i vejm në dijeni parashtruesit të Kërkesës për rishqyrtim se Institucioni jonë mbështetet në funksionimin ligjor dhe institucional, kurse lidhur me akuzat e ngritura i bëjm me dije se pretendimet e frikesimit dhe shantazhit ndaj institucionit dhe stafit NUK do i tolerojm dhe do ndermarrmi veprime ligjore lidhur me akuzat e ngritura.***

***Pamvarësishtë kësaj procedure që do e ndërmermi, ne jemi të përkushtuar të japmi përgjigjet sipas pretendimeve.***

Pretendimi nr.1-në kuadër Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ne dosje tenderit është formuluar kërkesa si ne vijim: Lot 1 Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet te ofroje dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata për punë të ngjashme në tri vitet e fundit nga data e publikimit te këtij njoftimi për kontratë- në vlerën minimale prej 2,000,000.00 euro.

Lot II Kërkesa 1. Kontrata të natyrës së punëve të natyrës se kontratës, ujësjellës, kanalizim te përfunduara me Sukses gjatë 3 (tre) vitet e fundit, deri në datën e publikimit të këtij Njoftimi te Kontratës, Vlera Totale e Kontratave të natyrës së punëve të ndërtimit të ujësjellësve, kanalizim te jetë minimumi i vlerës prej 2,300,000,00 EUR (dy milion e treqind mije), dhe se paku një kontrate te përfunduar me sukses ne ndërtim te ujësjellësit ne vlere min 1,400,000.00

- Fillimisht duhet theksuar faktin së është hëra e parë në aktivitete të prokurimit të natyrës se puneve te tenderit, ndërtim ujësjellësi vendosja e ketyre kriterëve të panevojshëme, favorizuese /diskriminuese duke eliminuar konkurrencen.

- Kjo kërkesë nuk ka asnjë kuptim apo logjike për pune te njëjta ne te njëjtin aktivitet te prokurimit kërkohe Lista te kontratave te ndryshme për Lot 1 dhe 2, ku për Lot I është kërkuar pune te ngjashme, ndërsa për Lot 2 punë natyrës se kontratës se kontratës, dhe se paku një kontrate te përfunduar me sukses ne ndërtim te ujësjellësit ne vlere min. 1,400,000.00. Me këtë kërkesë shihet qarte diskriminim të hapur dhe përcaktim të fituesit qysh tani për këtë aktivitet te prokurimit, andaj kërkojmë nga ana juaj që të analizoni në tërësi dosjen e tenderit dhe të bëni ndryshimet e nevojshme, konform kërkesave tona te cilat janë të bazuara ne dispozita ligjore.

#### ***Pergjigja e AK në pretendimin nr.1***

***NJK në bashkëpunim me Zyren e Prokurimit kan hartuar kërkesat konform standardeve të aplikueshme për natyren eAP.***

***OE duhet të ketë rezonin e kuart rrethë kërkesave sipas ndarjes së projektit në lote dhe duhet kuptuar se secili lot është aktivitet në vete dhe do të jetë edhe kontratë në vete.***

***Nga të cekurat konsiderojm se mungon rezonimi i parashtruesit të kërkeses lidhur me këtë aktivitet prokurimi.***

Pretendimi nr.2 - ne kuadër Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ne dosje tenderit është formuluar kërkesa si ne vijim: Lot I B) OE duhet te dëshmoj se ka autorizuar aje inxhinier te diplomuar ose mastar Drejtimi Infrastrukturë Rrugore (jo bachelor), kërkohe te ketë min. 5vite përvojë pune pas diplomimit-angazhime profesionale pas diplomimit, (Nëse shkollim është kryer jashtë Kosovës diploma e fakultetit duhet të jetë e nostrifikuar konform ligjeve ne fuqi te Republikës se Kosovës)

(kontratën e punës noteriale me vërtetim nënshkrimi ose të ketë parakontratë noteriale me vërtetim nënshkrimi të noteri)

- Kërkesa e AK-së Është totalisht e pa nevojshme që të prezantohet inxhinier i diplomuar ose master. Drejtimi Infrastrukturë Rrugore, me këtë kërkesë po tentohet te favorizohet një kompani e caktuar e cila do ta ofronte një inxhinier te tille dhe rrjedhimisht kjo kërkesë te cilën ju e keni vendos ne FDT nuk përkon me natyrën dhe qëllimin e punimesh e në këtë tender.

- Kur kemi parasysh Taktin se aktiviteti i prokurimit ka të bëj me ndërtimin të ujësjellësve e o me ndërtim apo riparim të rrugëve, është shume i qarte fakti se inxhinieri i kërkuar drejtimin Infrastrukturës Rrugore është i panevojshëm ne këtë aktivitet te prokurimit asi kërkesa e lartcekur nuk përkon fare me natyrën dhe qëllimin e ket

aktiviteti te prokurimit AK-ja ka vendosur këtë kërkesë e cila siq e cekëm është e panevoishme në këtë tender e cila i pershtatet nje OE të caktuar, mirepo që në kete rast kërkesa e tille nuk mund dhe nuk duhet të kërkohe.

Gjithashtu është kërkuar për të gjithë stafin profesional kontrata punës noteriale, e cila eshte pa nevojshme si dhe favorizuese për operatorët ekonomik, për faktin se përderisa një kompani do te ofron kontraten ose parakontraten per angazhimin në këtë projekt është dokument i mjaftueshem për ta përmbushur kërkesën e lartcekur. Prandaj kërkesa juaj që ky dokument të jetë edhe i noterizuar, për ne është i pa kuptimtë dhe i pa nevojshëm.

Andaj kerkojmë që të detyrohet AK-ja që kërkesen e lartecekur të largoj nga dsja e tenderit.

### ***Pergjigja e AK në pretendimin nr.2***

***OE lidhur me pretendimin e ngritur sipas shijes e vlerësimin të tij, nuk paraqet bazën e kërkeses, i njejt i me asnjë provë nuk ka arritur ta dëshmojë me argumente apo fakte në perspektivën e kontekstit e gjendjes faktike dhe juridike e që është minimumi profesional dhe ligjor për një kërkesë pretenduese e të bazuar në standardet e etikës profesionale.***

***Për faktin se një kërkesë e tillë është e paqartë, jo e plotë dhe e paprovuar është në kontradiktë ose ka dallime esenciale me gjendjen e plotë faktike dhe nuk përbën argument se pretendimi në fjalë është bindës dhe i provuar.***

Pretendimi nr.3- ne kuader Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ne dosje tenderit eshte formuluar kerkesa si ne vijim: Lot I C) OE duhet te dëshmoj se ka autorizuar një inxhinier te diplomuar ose master Drejtimi Mbrojtje e Mjedisit, të jetë i çertifikuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor te Republikës së Kosoves për Mbrojtje të Mjedisit, te jetë I çertifikuar me Iso 14001 2013 (jo bachelor), kërkohe te ketë min. 5 vite përvojë pune angazhime profesionale pas diplomimit. (Nëse shkollimi është kryer jashtë Kosovës diploma e fakultetit duhet të jetë e nostrifikuar conform ligjeve në fugi të Republikës së Kosovës)

Kerkesa e lartcekur nga ju është kërkesë e pakuptimte ose është bërë gabim teknik sepse inxhinier te diplomuar ose master Drejtimi Mbrojtje e Mjedisit duhet për aktivitete te prokurimit që kanë të bëjnë me hartim te projekteve, para se të filloj zbatimi i projektit, e jo tani ne fazen e ekzekutimit te projektit

Pyetja hipotetike në këtë rast është se çka do te ndodhë nëse gjate zbatimit të projektit inxhinieri del dhe përpilon një raport negativ per mbrojtje te mejdisit. Si do të veprohet ne nje sitate të tillë (a do të dështoj projekt i apo si do të veprohet

Kjo kërkesë është më të vërtetë kufizuese dhe favorizuesc. sepse-eshlë e panëvoishme qe inxhinier të diplomuar ose master Drejtimi Mbrojtje e Mjedisit të jetë edhe çertifikuar nga Ministria Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor te Repablikës së Kosovës per Mbrojtje 12 Mjedisit, gjithashtu të jetë I çertifikuar me Iso 14001 201 mirëpo natyra diskriminuese e kësaj kerkesa manifestohet me teper se k pasi që në dosjen e tenderit nuk është kërkuar thjeshte një inxhinier te diplomuar mbrojtje e mjedisit por eshte kërkuar që incinieri miedat te jetë Fi certifikuar edhe ngn Ministria e Mjedisit sr dhe certifikuar me Iso 1400 2013.

Prunga cilido kendvështrim imundshem, kjo kerkesty Die formaluar nu ketd menyre ishe mlant diskelmnueper shumicen absolute OE RKS dhe jkonsishteEshtë Ererizues Nuk Içohete të kombinohet kerkesa për stil profesionalme centifikata ge in kredesish nike Kerkesa për staž prótoslonil duhet lë ze le e eduro nea ketkesal eventinie per pecdike e pse kombinimi tyru Gltë kutizim i dreppendrejte

### ***Pergjigja e AK në pretendimin nr.3***

***AK – ZPP sqaron se nuk merreme me hipoteza e as supozime, mirpo A.K. i rikujton OE ankues se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë A.K. për njohjen e kapaciteteve minimale të OE, të cilët nëpërmjet dokumentacionit duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme të kapaciteteve ekonomike, financiare, teknike, profesionale, përvojën e duhur, personelin e nevojshëm dhe gjithçka tjetër në funksion të realizimit me sukses të kontratës.***

Pretendimi nr.4-ne kuader Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ne dosje tenderit eshte formuluar kerkesa si ne vijim: Lot I D) OE duhet te dëshmoj se ka autorizuar një inxhinier te diplomuar ose master Drejtimi Komunikacion(jo bachelor),, kërkohet te ketë min. 5 vite përvojë pune-angazhime profesionale pas diplomimit. (Nëse shkollimi është kryer jashtë Kosovës diploma e fakultetit duhet të jetë e nostrifikuar konform ligjeve në fuqi të Republikës se Kosoves)

Sikurse ne pretendimin nr.2, ju edhe ne pretendimin lartcekur nr 4, tek Kerkesa D), Ju ne këtë mënyrë keni formuluar kërkesa jorelevante në këtë DT qe nuk përkon fare me natyren dhe qellimin e këtij aktiviteti të prokurimit, andaj edhe per kete kerkese ju sqarojme se e njejta eshte e panëvojshme, favorizuese/diskriminuese, sepse nuk ka as baze logjike dhe as ligjore që të kërkohet një inxhinier te diplomuar ose master Drejtimi Komunikacion ne projekte te ndertimit te ujesjellsve, po e riperserisim se projekti nuk ka te beje me ndërtim apo riparim të rrugve, me kete kerkese njëkohësisht pamundeson ofertimin OE me shume pervoje qe kane te perfunduar projekte ne lemire e ketij aktiviteti te prokurimit.

Me këtë kërkesë po tentohet te favorizohet një kompani e caktuar e cila do ta ofronte nje inxhinier të tillë edhe pse natyra e aktivitetit të prokurimit nuk përkon me këtë kërkesë të cilën ju e keni vendos ne FDT. Prandaj kërkojmë nga ju si autoritet ta largoni këtë kërkesë nga dosja e tenderit pasi që e njëjta nuk përkon me këtë aktivitet të prokurimit.

### ***Pergjigja e AK në pretendimin nr.3***

AK – ZPP siguron se konform aktivitetit janë përdor me profesionalizëm edhe kërkesat, cdo her duke kërkuar minimumin dhe duke mundësuar konkurrencën per OE – profesionistë, të përgjegjshëm dhe nuk qendrojn pretendimet e favorizimit.

Pretendimi nr.5-ne kuader Kerkusat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ne dosje tenderit eshte formuluar kerkesa si ne vijim: Lot I Dh) OE dohet te dëshmoj se ka autorizuar një inxhinier te diplomuar ose master Drejtimi Menaxhimi i Emergjencave (jo bachelor) kërkohet te ketë min. 5 vite përvojë pune -angazhime profesionale pas diplomimit (Nëse shkollimi është kryer jashtë Kosovës diploma e fakultetit duhet të jetë e nustrifikuar conform ligjeve në fuqi të Republikës së Kosoves

Kerkesa e lartcekur nga AK-ja që inxhinieri diplomuar ose master Drejtim Menaxhimi Emergjencave (jo bachelor), është kërkesë diskriminuese per OE të cikt kanë endaar t2 ofertojnë ne kete aktivitet të prokōrimit. Po ashu kjo këikesë ju pamandëson ofertimin kompanive te cilat nuk e posedoini inxhinerin e kërkuar me master. Kjo kërkesë eshte kërkesë diskriminuese sepse punen që është paraparë la kryej inxhinieri i kerkumund ta kryejedhe n inxhinier me bachelor me 3 vitë provoje pune

Andaj kerkojmë që ta detyroni AK të ndryshoi kërkesën e lartcekur duke ulur kërkeszn z master,scepse kështu sig e ka specifikuar këtë kërkesë, shihet qartë së e nxfita është edestinuar per OLe caktuar tu cilat e posedojne inxhineria me master te kërkuar nga AK-ja

### ***Pergjigja e AK në pretendimin nr.5***

***AK – ZPP sqaron se nuk merreme me hipoteza e as supozime, mirpo A.K. i rikujton OE ankues se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë A.K. për njohjen e kapaciteteve minimale të OE, të cilët nëpërmjet dokumentacionit duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme të kapaciteteve ekonomike, financiare, teknike, profesionale, përvojën e duhur, personelin e nevojshëm dhe gjithçka tjetër në funksion të realizimit me sukses të kontratës.***

Pretendii r6-ne kuader Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ne dosje tenderit eshte formuluar kerkesa si ne vijim: Lot I OF duhet te deshmoj se ka autorizuar afë achrdar te dinlampar Drejtimi Gjedder Duhet te jeu i trajnuar per pirdorimin e droneve icnderik (Dokument ye deshmon ndjekjen e trajnimit), kërkobet te kete min 3 vite pereje pangarhime profesionale pas diplomimit (Nise shollimi tshte krver jashte kusove diploma e fakultetit duhet të jetë e nostrifikuar konform ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës).

DT në formën sikurse është publikuar nga autoriteti kontraktues, në mënyrë të hapur shperfaqë tendencën e AK-së për të favorizuar një operator të caktuar ekonomik dhe natyrisht është kërkesë që e kufizon konkurrencën për këtë aktiviteti te prokurimit.

Dilema tjetër manifestohet për faktin se AK në mënyrë krejt paradoksale/kundërthënëse kërkon që një bachelor të diplomuar Drejtimi Gjeodezi që i ka përfunduar studimet univerzitare për disa vitë në fushën e Gjeodezise, të jetë i trajnuar për përdorimin e dronëve gjeodezik, rrjedhimisht kërkesa FDT-së si e tillë është e palogjikshme përderisa kërkohën

dokumente per trajnime te dronve. Prandaj AK duhet të riformuloj kërkesën e DT ashtu që të largoj pjesën që bachelori gjeodezise e të jetë i trajnuar për përdorimin e dronëve gjeodezik, ndërsa pjesa e kërkesës për bachelor gjeodezise mund te mbetet e pandryshuar.

***Pergjigja e AK në pretendimin nr.6***

***AK – ZPP sqaron se nuk merreme me hipoteza e as supozime, mirpo A.K. i rikujton OE ankues se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë A.K. për njohjen e kapaciteteve minimale të OE, të cilët nëpërmjet dokumentacionit duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme të kapaciteteve ekonomike, financiare, teknike, profesionale, përvojën e duhur, personelin e nevojshëm dhe gjithçka tjetër në funksion të realizimit me sukses të kontratës.***

Pretendimi nr.7-ne kuader Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ne dosje tenderit eshte formuluar kerkesa si ne vijim: Lot 1 Minimum 1 teknik të gjeodezisë ose Eose bechelor i gjeodezisë i Minimum 1 teknik të komunikacionit ose bechelor ikomunikacionit

Kjo kërkesë është jo vetëm në kundërshtim me nenet 1, 7 dhe 69 te LPP, por kërkesa si e tillë është edhe e palogjikshme, është shumë i qartë fakti se tekniket e kërkuar të gjeodezisë dhe teknik të komunikacionit janë të panevojshëm në këtë aktivitet të prokurimit, kjo për arsye se projekti ka të bëjë me ndërtimin te ujesjellsit dhe nuk ka as bazë logjike dhe as ligjore që të kërkohet një teknik te komunikacion ne projekte te ndertimit te ujesjellsve

AK-ja është dashur të këtë parasyshtë rendesin e saldimit të gypit, të kërkoj teknik apo saldues të çertifikuar për saldimin e gypave të ujit, sepse janë me mija metra gjatësi të gypit të ujit që duhet salduar, por AK-ja ka formuluar DT në këtë mënyrë diskriminuese duke kërkuar teknik

te panevoishem.

Gjithashtu kerkesa e teknikut te gjoodezise" pu nëvojshme sepse është kërkuar një inxhinier të eku kjo kërkesë vlersojme se është totalisht e tillë dhe kerkesa e teknikut nuk ka nevojë që të kerkohet sepse eshte diskrimnuese, dhe padyshim se qëllimi i njëjtë i AK nuk do te mund të arrihet edhe pa këto kerkesa te panevoishme diskriminuese.

Pretendimi ar ne kuader Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ne dosje tenderit eshte formuluar kerkesa si ne vijim: Lot 1 Kërbesa. Operatori Ekomuntik duhet te poseilaje mjetit, stahilimentet dhe pajisjet tekaike që janë te domosdoshme për realizimin e

projektit, Paisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin je DT Makine per shpine horizontale nestokesore me sistem te kontrollis laser prej DN 110 mm- 550 2 Cope ju si AK me këtë kërkesë keni shkelur Nenin 7 të LPP-së Barazia në Trajtim/Jo- Diskriminimi, kërkesa që makina të jetë me system te kontrollit laser me dimensionet e kerkuara është pa nevoishme dhe absurde, per arsye se projekti eshte sitem ujesjellsit dhe absolutisht nuk ka nevoje per kete makine me llaser, qka do te thote se eshte favorizuese dhe shkon në drejtim të favorizimit vetem të një kompanie të caktuar, e ku po ju njoftojme se në tregun e Kosovës sipas informatave që i kemi e ka vetëm kompania Union Raketa, prandaj duhet të largohet si kërkesë që makina të jetë me system te kontrollit laser me dimensionet e kerkuara, sepse nuk e posedon askush përpos një kompanie te cilën neve si OE jemi ne dijani, dhe qe mendojmë se është diskriminuese dhe favorizuese sepse te gjitha kompanitë bien nga konkurrenca dhe qe është kriter vetëm për një kompani te caktuar.

Pra nga cilido këndvështrim i mundshëm, kjo kërkesë e DT e formuluar në këtë mënyrë është mjaft diskriminues për shumicën absolute të OE në RKS dhe njëkohësisht është favorizues vetëm për një (1) OE të caktuar ekonomik, sepse nuk e posedon askush, vetëm kompania Union Raketa në tregun e Kosovës, dhe me këtë kërkesë faktikisht është përcaktuar qysh tani fituesi i ketij tenderi nga AK-ja. Kjo kërkesë është më të vërtetë kufizuese dhe favorizuese, prandaj për të pasur një aktivitet të mirëfilltë të prokutimit dhe me kriteret korrekte e ligjore, definitivisht duhet të heqet- largohet kërkesa që makina per shpime horizontale të jetë me system te kontrollit laser sepse janë kërkesa te pa nevoishme.

***Pergjigja e AK në pretendimin nr.7***

***AK – ZPP sqaron se nuk merreme me hipoteza e as supozime, mirpo A.K. i rikujton OE ankues se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë A.K. për njohjen e kapaciteteve minimale të OE, të cilët nëpërmjet dokumentacionit duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme të kapaciteteve ekonomike, financiare, teknike, profesionale, përvojën e duhur, personelin e nevojshëm dhe gjithçka tjetër në funksion të realizimit me sukses të kontratës.***

Pretendimi nr.9-ne kuader Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ne dosje tenderit eshte formuluar kerkesa si ne vijim: Lot 1 Paisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT.

PAISJE GJEODEZIKE: GPS GNSS RTK-Advanced Engine System me 1408 kanale satelitore, me dual kamerë në kokë-resiver, controller Handy me dual kamerë në controller-terminal, me opsion rilevimi-skanimi 3D me fotografi dhe piketimi real me kamere dhe software 3D model.+ TOTAL STATION Robotic+GPS+Hybrid TOTAL STATION me laser 1000m' dhe saktësi 1 sekond. 1 Copil dhe PAISJE GJEODEZIKE: Dron Gjeodezik me sistem rtk me kamer to integruar minimum

Po ashtu ju njoftojmë se duke vlersuar se këto kriteret te cilat i ka percaktuar AK, në këto aktivitet jane kriteret diskriminuese duke favorizuar vetem nje kompani, me mekaizem te precizuar dhe te panevoishem ne prejktin e ujesjellsit.



Venja e ketyre puisjeve gjeodezike diskriminuese favorizuese dhe te kufizuar duke specifikuar saktesi me 1 sekond, me laser 1000m, me skanim 3D, gjithashtu dy (dron) gjeodezik duke specifikuar saktesi me 48MP, me kete kerkese AK-ja vetem sa nak ka shenuar emrin Ol ekonomik te cilin e ka favorizuar me kete mekanizem te pa nevoishem per keto projekt, ku si i tille shihet qare se eshte kriter favorizues, Pyetja edhe ne ketë rast eshte te na sqaroni qfare kuptimi ka te kerkohet paisje gjeodezike te tilla (çfare projekti ka menduar AK-ja qe ka publikuar)?, me kerkesa per dy dron gjeodezik dhe nje paisje gjeodezike me stacion total,

Projekte per hapje te tuneleve me mija kilometra?, hartim projekteve per ingjizim te hartave zonale?, apo ka publikuar projekt per ndertim te ujesjellsit, kerkojme nga ju te na sqaroni per qfare nevoiten keto paisje per kete tender.

AK-ja eshte dashur te ketë parasyshë edhe per LOT I sikuse ne LOT 2 rendesin e saldimit të gypit, të kërkoj mekanizem për saldimitin e gypave të ujit, sepse janë me mija metra gjatësi të gypit të ujit që duhet salduar.

Prandaj kërkojmë nga ju si autoritet ta largoni këtë kërkesë nga dosja e tenderit pasi që e njëjta nuk përkon me këtë aktivitet të prokurimit.

Pretendimj nr.10-ne kuader Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ne dosje tenderit eshte formuluar kerkesa si ne vijim: Lot 1

Bulldozer D5 1 Copë, Çekan pneumatik ose hidraulik, Lugë ngarkuese me peshë minimum 3 tonë deri maksimum 10 tonë. Cilinder për ngjeshje të zhavorit minimum 10 tonë deri maksimum 15 tonë. Cilinder për ngjeshje të zhavorit me dhëmbëza minimum 15 tonë. Cilinder për ngjeshje të zhavorit me dhëmbëza minimum 1 tonë deri maksimu 1.5 tonë Makinë vetëshkarkuese-Damper me peshë min. 3 tonë deri maksimum 4 tonë.2 Copë, Makinë për prerje dhe lakim të armaturës 1 Copë, Auto pompë betoni 1 Copë, Auto Mikser betoni3 Copë

Ju si autoritet kontraktues me qëllim jeni duke kërkuar pajisje te pa nevoishme e që nuk do te përdoren pothuajse fare ne këto punime, mirëpo këto kërkesa vetëm sa po i ngarkojnë operatorët ekonomik dhe po i shtyni drejt heqës dore për te konkurruar në këtë aktivitet te prokurimit, prandaj edhe për këto kërkesa te pa nevoishme per projekte te ujesjellsit ne kërkojmë nga ju që ti largoni në tërësi, si dhe dallimit kaq te madhe te kerkeave te mekanizmit ndermjet LOTI dhe LOT 2 per te njejtin aktivitet te prokurimit

Bulidozer DS vlersojmë se eshte kriter i pa nevoishme dhe e pa justifikuar, është kriter(Diskriminues), dhe rrjedhimisht kjo kërkesë nuk përkon me natyrën dhe qëllimin e punimeve në këtë tender sepse ne ndertim te ujesjellesve nuk nevoitet nje Buldozer i tille dhe qe ka peshe kaq te madhe mbi 19 ton, i cili perdoret vetem ne gurthyes si dhe ne ndetim te rrugeve, dhe nuk ka ndonjë efekt-ndikim ne ket projekt dhe nuk hyn ne pun fare, sepse ka vetem hapje dhe mbulim kanali

Çekan pneumatik ose hidraulik-AK-ja ka percaktuar ketë kerkese te pa arsyshme dhe te pa ligjikshme per arsye se toka ku do te punohet (Hapje dhe mbilim kanali eshte e kategoryse III dhe IV dhe nuk nevoitet fare çekuni perdoret vetem ne gurthyes(thyrje te Gurit).

Lugë ngarkuese me peshe minimum 3 tone deri maksimum 10 tone. Po ashtu ju njoftojmë se venja e ketij mekanizmi te kufizune per projekte te ujesjellsit eshte e pa nevoishme si dhe kutizuese për operatorët ekonomik, prandaj ne kërkojmë që kjo kërkesë te largohet

Cilinder për ngjeshje të zhavorit minimum 10 tonë deri maksimum 15 tonë. Cilinder për ngjeshje të zhavorit me dhëmbëza minimum 15 tonë. Cilinder për ngjeshje të zhavorit me dhëmbëza minimum 1 tonë deri maksimum 1.5 tonë asnjë pozicion ne paramase nuk eshte parapare te kryhet pune per shtrim te rrugve, e qe nevoiten cilindra me dhembza deri dhe mbi 15 tone, po ashtu dhe cilinder me dhembza me peshe te precizuar 1-1.5 tone, e ne ket rast nese perdohet ky cilinder me dhembza ne kanal do te shtypet komplet gypti i ujesjellsit. Prandaj kërkojmë që keto kritere të largohen nga dosja e tenderit, sepse me këtë kërkesë po tentohet të favorizohen kompani të caktuara e cila do ta ofronte një mekanizem të tillë.

Makinë vetëshkarkuese-Damper me peshë min. 3 tonë deri maksimum 4 tonë.2 Copë, Makinë për prerje dhe lakim të armaturës 1 Copë, Auto pompë betoni 1 Copë, Auto Mikser betoni 3 Copë -Makinerite e lartecakura te cilat AK-ja i ka vendosur ne dosje tenderit, jane te panevojshme per kete aktivitet te prokurimit dhe te nejtat duhet te largohen nga dosja tenderit, po ashtu ju pamundesojne ofertimin operatove ekonomik me pervoje ne kete fushe.

Kufizimi i Damper 3 deri 4 tonë dhe ate sasia 2 cope janë totalisht diskriminuese dhe nuk mund të bëhet kufizimi i peshës maksimale dhe peshës minimale me peshe kaq e precizuar duke specifikuar pesha te caktuara tone e ton te cekur me nje kufizim te tonazhit ne kete forme nuk ka asnje shpjegim logjik spo ligjor, pozicionet përkatëse ku mund të shfrytëzohen Damper mund të realizohen edhe përmes tonazheve tjera psh. 2 ton, etj.

Ngjashëm vlen edhe për Makinë për prerje dhe lakim të armaturës, Auto pompë, Auto Mikser janë kërkesa të panevojshëm për këtë aktivitet të prokurimit dhe natyrisht që e kufizojnë konkurrencën, dhe nuk kanë ndonjë efekt-ndikim dhe për këtë aktivitet të prokurimit. Prandaj kërkojmë që të ndryshohet plotësohet lista e pajisjeve sipas konstatimeve më sipër.

Kerkesat per paisje si te tilla diskriminuese pasi qe kufizimi i tonazhit ne kete forme nuk ka asnje shpjegim logjik apo ligjir perderisa nuk ekziston asnje pozicion ne paramase sipas te cilit do te mund te kofizohet tonazha e ketyreve paisjeve ne kete forme. Prandaj për të pasur një aktivitet të mirëfilltë të prokurimit dhe me kritere korrekte e ligjore, ju duhet të largoni këto kërkesa nga DT.

***Pergjigja e AK në pretendimet e cekura:***

***AK – ZPP sqaron se nuk merreme me hipoteza e as supozime, mirpo A.K. i rikujton OE ankues se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë A.K. për njohjen e kapaciteteve minimale të OE, të cilët nëpërmjet dokumentacionit duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme të kapaciteteve ekonomike, financiare, teknike, profesionale, përvojën e duhur, personelin e nevojshëm dhe gjithçka tjetër në funksion të realizimit me sukses të kontratës.***

Pretendimi nr.11 Lot 1 Pas pranimit te projektit ne forme elektornike (CD) ju informojne se ka manges) (diskrepance) te madhe mes projektit dhe paramases.

Viene te ceket se duke krahasuar te dhenat ne parnmase dhe paralogari ne ate me projektin e pranuar nga ana e juaj, disa pozicione ndryshojne sasite kurse disa te tjera nuk jane te parapara fare ne paramase, ato jane

a) Tek kapitulli "Stacioni pompak deri ne rez, Samautreshe pretendohet per ekzekutimin e kabilove per furnizim me energji Manzon mes st pompimir dhe rezervuarit

19 Lek Kapitulli i Rezervuarit V-1000m Mungon skema apo detali i armimit te rezervuarit per te gjitha etapar e zhvillimit. linjat ku planifikohen te shtrihet kabllloja per furnizim me energji dhe komandimin e pompave mes st.pompimir dhe rezervuarit.

d) Tek "Ujesjellesi ne fsh. Beçiq dhe Dubove" - Mungon definimi i gypave me presion te ndryshem si dhe sasia ne krahasim me paramase nuk perputhen (ka diskrepance te madhe).

e) Tek "Ujesjellesi ne fshatin Gllavotin" dhe "fsh. Prelluzhe" - Sasia e gjatesise se gypave ne projekt ne krahasim me sasine ne paramase, nuk perputhen (ka diskrepance te madhe).

l) Tek "Ujesjellesi per fsh. Samadrexhe, Sfaraqak, Ropic, Maxhunaj, Dumnice e poshtme, Stanove i eperm dhe Grace" - Mungon definimi i gypave me presion te ndryshem si dhe sasia ne krahasim me paramase nuk perputhen (ka diskrepance te madhe).

Ju informojme se projektet hartohen me qellim qe te mos kete nevojte per ritenderim dhe pune shtese. Kjo jo vetem qe ka kosto shtese financiare per komunat po shkakton edhe hubje te kohes me shtim te procedurave.

Me këtë veprim ju kenë rënë në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 19.17 të Rregullores për Prokurim Publik nr.001/2022, ku përcaktohet qartë "Projekti Ekzekutues është një dizajn grafik i te gjitha proceseve administrative dhe inxhinierike të punimeve të kërkuara siç është përshkruar në Specifikat Teknike dhe prandaj, parashtron, në raste të veçanta, punime arkitektonike, strukturore të punëve që do të ekzekutohen

Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e Projektit Ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet t'i bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë të dosjes se tenderit

Me këto kërkesa nuk mundësohet pjesëmarrje e gjerë e operatorëve ekonomik, por në këtë mënyrë është kufizuar tej mase konkurrenca dhe këto kërkesa janë drejtpërdrejtë jo në harmoni me çmimin dhe lëndën e prokurimit, sepse kur kufizohet konkurrenca me kërkesa të pa nevojshme atëherë edhe çmimi ofertues i operatorëve ekonomik të favorizuar automatikisht është shumë më i lartë, ndërsa kjo ndodh për shkak se nuk kanë konkurrencë dhe faktikisht determinohet çmimi nga ana e autoritetit kontraktues në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit dhe pothuajse eshte pashmangshme demtimi i buxhetit.

Me keto kërkesa që tani dihet fituesi i këtij tenderi dhe pastaj mundësia është shumë e madhe e dëmtimit të buxhetit sepse kompania që e plotëson këtë kërkesë normalisht që oferton me çmim më të shtrenjtë.

Këto kërkesa bien ndesh plotësisht me nenin 7 të L.PP-së përkatësisht paragrafet 1, 2, 3 dhe 6. Paragrafi 1 i nenit 7 parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe do te veprojë në mënyre transparente"

Me këto kërkesa, jo që nuk mund të ketë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik por do të ketë diskriminim të hapur dhe përcaktim të fituesit qysh në start të këtij aktiviteti të prokurimit, pa konkurrencë të hapur dhe natyrisht që mundësia e dëmtimit të buxhetit është shumë e madhe. Paragrafi 6 i dispozitës së nenit 7 parasheh qartë Gjate udheheqjes së aktiviteteve të prokurent te sitha storitetet kontraktuese do të sigurojnë: 10 pjesëmarrjen sa më te gjernv te amandslame to operatoreve te interesarr ekonomik lidha me çmimin dhe lendeu e prokurimit

Me këto kërkesa nuk mundësohet pjesëmarrje e gjerë e operatorëve ekonomik, por në këtë mënyrë është kufizuar tej mase konkurrenca dhe këto kërkesa janë drejtpërdrejtë jo në harmoni me çmimin dhe lëndën e prokurimit, sepse kur kufizohet konkurrenca me kërkesa të pa nevojshme atëherë edhe çmimi ofertues i operatorëve ekonomik të favorizuar automatikisht është shumë më i lartë, ndërsa kjo ndodh për shkak se nuk kanë konkurrencë dhe faktikisht determinohet çmimi nga ana e autoritetit kontraktues në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit.

Ju në këtë rast me këto kërkesa, nuk e keni pasur parasysh nenin 26.4 të Rregullave dhe Udhëzuesit operativ për prokurim publik, sepse aty shkruan qartë se "Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike". Pra jo vetëm që po ju pamundësoni ofertimin operatorëve ekonomik të themeluar rishtazi në kundërshtim me nenin e lartcekur, por po ju pamundësoni ofertimin edhe OE me përvojë të madhe në këtë fushë.

Ju me kërkesat e lartcekura të cilat ia keni përshtatur një OE të caktuar po e rrezikoni dëmtimin e buxhetit të shtetit, pasi që në momentin që përshtaten kërkesat atëherë OE të cilët i plotësojnë këto kërkesa do të ofertojnë me çmim shumë më të lartë, ashtu siç ka ndodhur në shumë raste.

Duke u bazuar në të gjitha këto kërkesa diskriminuese-favorizues dhe në dëshmitë e kërkuara, rezulton se në këtë mënyrë nuk mund të arrihet qëllimi këtij aktiviteti të prokurimit dhe qëllimi i LPP-së, siç parashihet në nenin 1 të këtij ligji, e ku shkruan qartë: Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe kundërshtimet tona që u cekën më lartë, rezulton se ju si autoritet kontraktues nuk e keni përpiluar dosjen e tenderit në harmoni me nenin 27 ( LPP- së dhe njëkohësisht nuk e keni pasur parasysh as nenin 18.9 të RRUOPP ku shkruan qartë që "Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk: Kufizon konkurrencën në mesin e QE, ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve.

Prandaj të gjitha kërkesat të cilat i kontestuar më lartë duhet larguar/ndryshuar për të pasur një aktivitet të prokurimit normal dhe për të mos u diskriminuar/favorizuar kompanitë e caktuara.

Gjithashtu pa dashur që këtë paralajmërim ta keqkuptoni, ju njoftojmë se këtë tender me këto kërkesa dhe dëshmi të kërkuara ne e konsiderojmë tender të kurditur dhe normalisht që nëse nuk ndryshohen kërkesat do të jemi të detyruar të bëjmë denoncime edhe në organet tjera të cilat i përkasin fushës penale.

***Pergjigja e AK në të cekurat:***

***AK – ZPP sqaron se nuk merreme me hipoteza e as supozime, mirpo A.K. i rikujton OE ankues se krëteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë A.K. për njohjen e kapaciteteve minimale të OE, të cilët nëpërmjet dokumentacionit duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme të kapaciteteve ekonomike, financiare, teknike, profesionale, përvojën e duhur, personelin e nevojshëm dhe gjithçka tjetër në funksion të realizimit me sukses të kontratës.***

Sa i përket pohimeve të ngritura kinse për shkelje të neneve të LPP-së, A.K. thekson se ky pohim është paragjykes, pasi që në kontekstin e rrethanave konkrete kjo dispozitë nuk ka të bëjë me çështjen konkrete, respektivisht nuk është e aplikueshme ose nuk ndërlidhen në situatën dhe procedurën e tanishme të këtij aktiviteti të prokurimit.

---

Në fund, A.K. thekson se vërtetohen dhe mbesin në fuqi të gjitha kërkesat, kushtet materiale dhe informatat tjera përkatëse të dosjes së tenderit sipas versionin që do të paraqitet, krejt kjo me arsyen se të njejtat garantojnë transparencë dhe konkurrencë të drejtë e të barabartë sipas praktikave më të mira për të gjithë OE që zotërojnë kapacitetet e nevojshme të lartcekura në funksion të realizimit me sukses të kontratës në raport me objektin dhe specifikat e fushëveprimtarisë së saj.

Nga se u tha më lartë, e në pajtim me dispozitat e lartcekura, A.K. vlerëson se nuk ka asnjë arsye të vensosë ndryshe nga ajo që është theksuar si më lartë, andaj edhe është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Drejtoria për Prokurim Publik

  
Ilmi Azemi

**Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim ka të drjtë të parashtrori Ankesë pranë Organit Shqyrtues për Prokurim – OSHP-së, në pajtim me nenin 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.**

Nga një kopje i dërgohet:

1x1 Palës/ ve;  
1x1 DPP, dhe  
1x1 Arkivit.